



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 2381/12 Prot

Fier më, 27/02 /2026

PROCESVERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 27.02.2026. Sot në sallën e mbledhjeve ora 14:30. Të pranishëm në mbledhje 33 këshilltarë.

Znj. Antoneta Çunaj

Përshëndetje të nderuar këshilltarë! Fillojmë mbledhjen e radhës. Përpara se të fillojmë mbledhjen e radhës në Bashkinë Fier ka ardhur një shkresë nga Partia Socialiste e Shqipërisë, dega Fier, me Nr. 2712Prot, datë 27.02.2026 ku Grupi i Këshilltarëve Socialist, ka vendosur zëvendësimin në detyrë të Kryetares së Grupit të Këshilltarëve Socialist, të këtij këshilli Znj.Evis Sema me Z.Marjus Voja. Kjo ishte një kërkesë e një subjekti. Është e drejta e subjektit politik që të bëjë zëvendësimin e kryetarit të grupit. Tani fillojmë me rendin e ditës.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës me përmbajtjen si më poshtë:

- 1. Miratimi i Rendit të Ditës.**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 29.01.2026.**
- 3. Projektvendim:** "Për miratimin e kalendarit vjetor të aktiviteleve të Këshillit Bashkiak Fier për vitin 2026"
- 4. Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Janar 2026."
- 5. Projektvendim:** "Për shpërndarjen e një banese sociale me qira, e cila rezulton e lirë nga administrimi i banesave sociale me qira pranç bllokut të Banesave Sociale, Lagja 16 Prilli', Fier, për familjet e pastreha."
- 6. Projektvendim:** "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit, të funksioneve dhe të shërbimeve të Bashkisë Fier."
- 7. Projektvendim:** "Për miratimin e ndryshimit (shtesë fondesh nga fondet e trashëguara të vitit 2025) në VKB nr. I18, datë 11.12.2025, Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2026'."
- 8. Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për familjet e fshatrave të Njësisë Administrative Levan nga përmbytjet e shkaktuara nga lumi Vjosa në datën 08.01.2026, si dhe

për familjet e Njesisë Administrative Nr. 2 Mbrostar Ura dhe Libofshë nga përmbytjet e shkaktuara nga lumi Seman në datën 11.01.2026.

9. Projektvendim: "Për dhënien e titullit Qytetar Nderi' z. Miti Nushi dhez. Lllazar Pove "

10. Infomacion Këshillit : Mbi Raportin e Monitorimit 12-mujor të Buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025"

11. Diskutime dhe komente.

Znj. Antoneta Çunaj

Rendi i ditës ka ardhur, është deklaruar, ku janë nëntë projekt-vendime dhe përveç nëntë projekt-vendimeve që janë pjesë e rendit të ditës për të cilat ju ka ardhur dokumentacioni, ka edhe këto dy pika shtesë të rendit të ditës, për të cilat është hedhur materiali të gjithë këshilltarëve, u janë hedhur online.

Pika e parë shtesë e rendit të ditës.

Projekt-vendim: "Për miratimin e formalizimit të marrëdhënies juridike për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim, njesisë vendore të kujdesit shëndetësor Fier, të objektit Qendra Shëndetësore numër 3, me numër pasurie 12/397, zona kadastrale 8552, me sipërfaqe 820 metër katror, e ndodhur në lagjen 'Iliria', Fier, pronë e Bashkisë Fier."

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.

Projektvendim:"Për një ndryshim në VKB numër 12, datë 29.01.2026, për miratimin e subvencionit të qerasë për familjet e pastreha që banojnë me qera në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qerasë."

Ndërsa, domethënë, këto janë vetëm dy pikat shtesë të rendit të ditës. Përveç këtyre dy pikave shtesë të rendit të ditës, nuk futen në rendin e ditës: pika tjetër "Për dhënien e miratimit për nxjerrjen nga inventari në përdorim të aktiveve të pasurisë, ndërtesë, llogaria ekonomike 212, ish-ndërmarrja e ujitjes dhe kullimit", si edhe një shkresë nga Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve, protokolluar në bashki me numër protokollit 2552, datë 25.02.2026, me lëndë "Kërkesë për dakordësi në kuadër të projektit: Projektimi i infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbetjeve në zonën e mbetjeve Fier."

Këto dokumentacione janë rikthyer përsëri administratës së bashkisë. E para për të saktësuar më tej, ndërsa e dyta nuk është e bërë gati për mbledhjen e radhës, projekt-vendimi i shoqëruar me dokumentacionin dhe me informacionin në lidhje me këtë kërkesë. Dakord? Tani hedhim në votim rendin e ditës, së bashku me dy pikat shtesë që lexova. Po, urdhëroni zoti Gëzim.

Z.Gëzim Hajdëraj

Një minutë, një minutë për procedurë, lidhur me rendin e ditës. Unë e pashë atë, edhe i kam parë relativisht këto kërkesat e rendit të ditës, por mendoj që jemi në fund të muajit shkurt, kemi para verën. Dhe doja të fusja në rendin e ditës, një informacion në lidhje me çfarë ka bërë bashkia për mbarëvajtjen e plazheve, të pushimeve, të pronave, të atyre aktiviteteve që lidhen me plazhet në Bashkinë Fier. Doja ta ngrija në rendin e ditës edhe me atë që është shumë e rëndësishme, gjithmonë sipas mendimit tim, për arsye se shumë nga pjesët e rendit të ditës kanë të bëjnë me probleme individuale. Por unë mendoj që rendi i ditës duhet të merret me probleme themelore dhe një nga këto është patjetër kjo që ngrita unë, se çfarë masash ka marrë bashkia



për sezonin veror. Kjo për arsye sepse nqs jeta e një individi ka përparësi për tu futur në rendin e ditës, kuptohet se sa rëndësi ka për tu future në rendin e ditës jeta e gjithë komunitetit. Janë me mijëra, me dhjetëra mijëra njerëz që frekuentojnë plazhet tona të Bashkisë Fier. Janë me dhjetëra e qindra objekte, janë me dhjetëra e qindra aktivitete private, të cilat kanë punësuar me qindra njerëz. Pra, ka një gjithëpërfshirje të rëndësishme për të cilën është shumë e rëndësishme të diskutojmë. Këtu jam ngritur dhe herë të tjera, dhe nuk është se nuk kam gjetur kujdesin e duhur apo predisozicionin e duhur, por unë mendoj që deti për Bashkinë Fier është një aset i paçmuar, të cilit duhet ti kushtohet një rëndësi veçanërisht e madhe. Është e pafalshme që mgjith se kam tre vjet që flas për gjendjen e rrugëve të cilat shkojnë në plazh. Sot e kësaj dite, gjendja e rrugëve është e njëjtë , asnjë lloj investimi. Në qoftë se do të më thotë ndonjë punonjës i Bashkisë që i referohet rrugës së Darëzezës, ajo nuk është bërë nga Bashkia, është bërë me fondet e FSHZH- së dhe pjesa që ka marrë përsipër për ta bërë Bashkia nga Fshati Darëzezë në plazh edhe sot e kësaj dite nuk është vënë asnjë lopat, përkundrazi gropat janë bërë nga gjysëm metri si në Kandahar.

Së dyti, doja të tërheq vëmendjen, zonja kryetare, për një incident që ka ndodhur, domethënë fare banal, por që mendoj që duhet të këtë vëmendje. Që sot nuk na është lejuar që të vijmë me makinë në territorin e Bashkisë. Nuk e di, ne jemi anëtarë të Këshillit të Bashkisë apo jemi të një institucioni tjetër. Ky territor i Bashkisë, nuk është vetëm i Bashkisë por dhe i Këshillit Bashkiak, dhe nuk e di pse mbahet ky qëndrim, dhe pse pikërisht sot? Është fyese, që të vish atje, dhe një roje me një arrogancë të pa parë, të të thotë kam urdhër, dhe ne arrijmë të kuptojmë që i ka krahët e ngrohta dhe ka marrë urdhër pavarësisht se nga kush, të na trajtojnë në këtë mënyrë. Tani ne jemi anëtarë të Këshillit Bashkiak, kemi identitetin tonë dhe nuk mundemi ne që të nëpërkëmbemi nga një pjestarë i Bashkisë, i cili në një mënyrë arrogante, fyese, i jep urdhër një roje, që të silltet në mënyrë arrogante dhe të mos lejojë mjetet tona brenda territorit të Bashkisë.

Znj. Antoneta Çunaj


Faleminderit!Po Visa.

Znj.Evis Sema

Vetëm një sqarim të shkurtër për sa i përket një përgjigje të shkurtër për kolegun. Pjesa e parë sikurse tha ai është nga FSHZH-ja, ndërsa po ju bëj me dije që projekti prej 560 milionë lekë të vjetra, për rrugën e Darëzezës, e cila është një investim i Këshillit të Qarkut së bashku me Bashkinë Fier, është prokuruar, janë bërë të gjitha procedurat, është leja e zhvillimit për tu nxjerrë e cila del këto ditë. Dhe javën tjetër ose sapa të dali leja e zhvillimit, fillon rruga e plazhit, investim i Këshillit të Qarkut dhe Bashkisë Fier. Dhe shumë shpejt me një afat prej 45 ditësh për përfundimin e asaj rruge.

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit!Tani në lidhje me pyetjen e parë, të nderuar këshilltarë.Tani në lidhje me pyetjen e parë, e njohur nga këshilltarët: Kam mendimin se për këtë lloj informacioni, pavarësisht se edhe anëtarja e Këshillit, zonja Visa Sema, sqaroi në lidhje me një rrugë, i lëmë detyrë përfaqësuesve të bashkisë, që sot nuk mundet pa marrë informacion nga drejtoritë, nuk mund të realizohet, mendoj. Megjithatë po qenë gati, unë jam dakord që të flasim përfaqësuesit e bashkisë. Por po s'qenë gati, unë jam e mendimit që të dali sa më e plotë, t'i lëmë kohë përfaqësuesve të bashkisë që mbledhjen tjetër të na japin një informacion të plotë dhe të detajuar për gjithçka që u kërkua nga anëtari i Këshillit, zoti Gëzim. Mendimi im... Edhe mos të zgjatemi. Në qoftë se doni të zgjatemi, hajde të zgjatemi. Po unë jam e atij mendimi që radhën tjetër të dalë e plotë, t'i marrim të tërat pikat me radhë, ju i kërkua, ta mbajnë shënim dhe t'i sqarojnë një për një apo çfarë, se realisht ka të drejtë. Për arsye sepse jemi vend me fat, jemi bashki me fat, që kemi edhe det, edhe fushë, edhe naftë. Dhe



përderisa kemi këtë det, duhet që në mënyrë dinjitoze të gjithë, mos të themi gjithë zona e jugut, pse mos ta shfrytëzojmë në mënyrë korrekte këtë... Kështu që mos ta zgjasim shumë se kështu do të vazhdojmë. Unë jam e mendimit që radhën tjetër, kur të jetë ky informacion i plotë nga ana e bashkisë, radhën tjetër unë jam e mendimit që të debatohet në lidhje me këtë fakt.

Z.Nustret Avdullai

Atëherë në lidhje me pretendimet për sezonin e plazhit: thjesht dua të jap një informacion të shkurtër, jam plotësisht dakord me ju. Detajet do t'u vijë në mbledhjen e ardhëshme, të detajuara. Por ne sapo kemi përfunduar të gjitha kërkesat e subjekteve për hapësira publike. Ne mbas mbarimit të këtij procesi, menjëherë do fillojmë për sezonin e plazhit, për të gjitha subjektet që operojnë. Por në dijeninë time, të gjitha subjektet që operojnë në plazhin e Darëzezës, në muajin tetor-nëntor, di që marrin një leje nga Ministria e Mjedisit dhe pjesa tjetër pastaj i takon bashkisë. Mbledhjen e ardhëshme, besoj do të keni disa probleme të detajuara dhe përgjigjet specifike për çdo problematikë. Ndërsa për rastin e makinave të parkuara: Në qoftë se ka ndonjë arrogancë nga punonjësit e policisë bashkiake, ju kërkojmë ndjesë dhe do ta rishikojmë, por për ta sqaruar saktë: problematika nuk është për këshilltarët, por ne me ardhjen e pesë makinave që i furnizojmë me energji elektrike, ne kemi bërë një impiant elektrik që ka zënë gati gjysmën (e parkingut) dhe kjo nuk është vetëm për këshilltarët, por është për të gjithë drejtorët se mundësia e vendit është e kufizuar dhe e limituar. Ne i kemi kufizuar të gjithë rreth e qark, të gjithë këshilltarët, të gjithë punonjësit e bashkisë, të parkojnë aty. Dhe kemi bërë një ndarje të tillë për pa mundësi të vendeve, jo se kemi penalizuar dikë. Kjo është e vërteta e asaj pune. Ndërsa për rastin në qoftë se një punonjës na pas sjellje arrogance, kjo na përket ne pastaj ta shikojmë. Faleminderit!

Z.Gëzim Hajdëraj

Së pari ka një keqkuptim të mendimit këtu, sepse nuk jemi palë, ne jemi këshilltarë që vendosim për juve dhe ju nuk ngrini pretendime. Dhe vetë fjala pretendim presupozon lartësi, që e shikon tjetrin nga lart, por jemi ne lart, jo ju. Së dyti, për sa i përket asaj që keni marrë juve, atje kishte vende bosh, nqs do të ishte plotë ajo ndryshonte puna por deri sa ka vende bosh nuk ka pse mos të futen makinat e këshilltarëve. Dhe së treti, deri sa jemi edhe të zanatit jemi në gjendje të kuptojmë nga mënyra se si komunikon, sepse komunikova me të dhe nuk është aq i thjeshtë ai problem aq sa e thjeshtoni ju, megjithatë nuk po e vëmë në diskutim sepse është një diçka e vogël. Për sa i përket problemit të detit nuk është aq e thjeshtë sa thoni juve se unë, juve nuk keni qënë atëhere kur unë e kam ngritur këtë problem para tre vjetësh, dhe po e përsëris prapë që ta dëgjoni edhe juve. Jemi i vetmi bashki! E vetmja bashki që nuk kemi ndërtime të përherëshme në bregdetin tonë! E gjithë Shqipëria... e gjithë bashkitë e Shqipërisë kanë ndërtimet të përherëshme. Vetëm ne s'kemi. Vetëm ne kemi ca baraka atje, që punojnë ata fierakët atje me shpirt ndër dhëmbë për të marrë dy lekë atje, të marrë dhe bashkia ca lekë këtu, se paguajnë taksat apo jo? Dhe pse? Pse pikërisht Fieri? Bashkia e Fierit nuk ka ndërtimet të përherëshme? Nuk lejon ndërtimet? Kur të gjitha bregdetet e Shqipërisë, i kemi me hoteleri, e me ndërtime të përherëshme pafund. Më gjej një bashki, ti që ka një rrugë një kalimshe për të vajtur në Semën, ku then pasqyrën. Vete në Darëzezë i ke gropat gjysëm metri. Më gjej një bashki tjetër në Shqipëri që i ka rrugët e plazhit që shkojnë bregdet, siç i ka Fieri?

Znj. Antoneta Çunaj

Zoti Gëzim, zoti Gëzim, të thashë që radhën tjetër do t'ju jepet informacioni i detajuar që ju kërkonit do t'ju jepet në mbledhjen e radhës. Do të themi radhën tjetër të gjitha nga A-ja tek Zh-ja. Dakort? E mbyllim tani këtë diskutim? Atëherë e mbyllim tani? Fillojmë me miratimin e rendit të ditës së bashku me dy pikat shtesë të rendit të ditës. Kush është dakort?



Pro 33 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka.

Miratohet.

Znj. Antoneta Çunaj

Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 29.01.2026.

Znj. Antoneta Çunaj

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 29.01.2026. Materiali u është dorëzuar të gjitha forcave politike, është firmosur prej tyre. Ka diskutime? Jo. E hedhim në votim. Kush është dakort ?

Pro 33 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka .

Miratohet.

Pika e tretë e rendit të ditës

Projektvendim: "Për miratimin e kalendarit vjetor të aktiviteve të Këshillit Bashkiak Fier për vitin 2026"

Znj. Antoneta Çunaj

Materiali ju ka ardhur, është material i përgatitur nga Bashkitë e Forta. E do ndonjë fjalën? Është i qartë materiali?

Znj.Edlira Dyrmishaj

I vetmi material që kemi ne është ky që thotë: Kryesia e Këshillit Bashkiak në bashkëpunim me Komisionet e përherëshme kanë hartuar planin e aktiviteve të Këshillit në zbatim të Ligjit X për vitin 2026. Nuk na është vënë në dispozicion cili është ky plani i hartuar.

Z.Armando Çupa

Kryetare, më fal. Atëherë, plani i aktiviteve, ashtu siç e sqaroi kryetarja, është i njëjtë me vitin e kaluar. Pra, është një material i cili është i njëjtë me vitin 2025. Është dërguar bashkëngjitur edhe plani, në formatin Excel dhe është i njëjti. I vetmi ndryshim është që është për vitin 2025, po bëhet për 2026. Është një detyrim ligjor që Bashkitë e Forta, në atë marrëveshjen që kanë bërë me Ministrinë e Brendshme dhe pushtetin lokal, e kanë vendosur si detyrim ligjor planin e aktiviteve për ta miratuar në Këshill. Është i njëjti me vitin e kaluar, thjesht ndryshon vetëm viti. Është aty në format Excel dhe nuk ka asnjë ndryshim. Faleminderit.

Z.Elvi Daka

Përsëritet të gjithëve. Duke parë me kujdes planin e aktiviteve, do të sugjeroja sepse në fakt po të shikosh aktivitetet janë përsëri të njëjtat: mbledhje komisionesh, mbledhje seanca por nuk shoh ndonjë evoluim apo zhvillim të vetë këshilltarëve, me trajnime, me ndarje eksperiencash. Do të ishte pak më harmonik i gjithë plani i aktiviteve, sepse po mbesim prej tre vitesh tashmë në të njëjtën kornizë. Do të doja që të kishte sa



më shumë pasurime me aktivitete të ndryshme, siç kemi parë që ndodh edhe në bashkitë e tjera. Ndoshta ne kemi një buxhet të përcaktuar në fillim për Këshillin Bashkiak, le ta vëmë në dispozicion edhe për të tilla aktivitete që i shërbejnë vetë formimit dhe rritjes sonë. Faleminderit.

Z.Armando Çupa

Më fal kryetare të bëj një sqarim në lidhje me këtë! Në fund të vitit të kaluar është miratuar shkolla ose akademja kombëtare e pushtetit vendor, e cila është në fazën e rekrutimit të drejtorit ekzekutiv. Trajnimet që deri dje ofroheshin nga "Bashkitë e Forta" meqenëse ky ishte një institucion që nga krijimi dhe deri në vazhdimësi do të asistojë nga ata do të kalojnë nëpërmjet këtij institucioni. Prandaj nuk janë parashikuar trajnime nga "Bashkitë e Forta", sepse ne, pavarësisht se nuk kemi një fond në dispozicion, ka institucione të licencuara e të certifikuar që ofrojnë këto trajnime. Dhe meqenëse kjo shkollë tashmë do të fillojë shumë shpejt (besoj brenda muajit mars do të jetë i mbaruar procesi i rekrutimit të drejtorit ekzekutiv), do të fillojë të funksionojë. Tashmë "Bashkitë e Forta" nuk ofrojnë më trajnime siç i ofronin deri dje, meqenëse është krijuar kjo shkollë, do t'i bëjë kjo shkollë. Faleminderit!

Znj. Antoneta Çunaj

Megjithatë, ky projektvendim ju ka ardhur. Kishin të drejtë komisionet të mbledheshin, edhe anëtarët e këshillit të thjeshtë kanë të drejtë të japin sugjerime. Nuk ka asnjë nga anëtarët e Këshillit... e kanë marrë atë projekt-vendim dhe nuk kanë bërë asnjë sugjerim, asnjë kërkesë me shkrim në sekretari. Bëni kërkesa, i sillni në protokoll t'i shikojmë. Dhe nëse këto kërkesat tuaja janë në përputhje me ligjin e financave që na lejon apo s'na lejon, hajde t'i bëjmë! Ne dakord jemi që të bëjmë.

Znj.Edlira Dyrmishaj

Ndoshta do të ishte udhës që këtë pikë ta shtyjmë për mbledhjen tjetër dhe ndërkohë ne të fitojmë kohën sepse, dakord, ajo akademja nuk varet nga çfarë kërkojmë ne...

Z.Armando Çupa

Atëherë, plani duhet të ishte miratuar që në muajin dhjetor. Për shkak të ngarkesës që ka pasur këshilli në muajin dhjetor ku u miratua buxheti dhe në mbledhjen jashtë radhe të muajit dhjetor, nuk është miratuar. Iu dërgua "Bashkive të Forta" për konsultim përpara se të sillej këtu në muajin janar, dhe ka ardhur në atë format që është. Megjithatë, kjo nuk na ndalon që ne ta miratojmë planin paraprakisht siç e kemi. Në qoftë se do të ketë nga "Bashkitë e Forta" kërkesë për të vendosur në agjendë (siç kanë vendosur gjithmonë edhe kur plani është miratuar), ose në qoftë se do të ketë nga ana e tyre fonde apo projekte për të asistuar përsëri këshilltarët, ai do t'i shtohet këtij plani dhe ju do të viheni në dijeni. Faleminderit.

Znj. Antoneta Çunaj

Fundja, ky një plan është. Plan mund të pasurohet gjatë gjithë vitit, nuk është se jemi vonë, në muajin mars. Plan është. Kush ka kërkesa, sugjerime apo gjëra të tilla, ne jemi të hapur që t'i bëjmë pjesë të këtij projekt-vendimi më vonë, kur të vijmë kërkesat tuaja dhe t'i shqyrtojmë. Dakord? E hedhim në votim.

Znj.Edlira Dyrmishaj

Kam edhe një pyetje të fundit për sekretarjatin, mqs është në linjën e kësaj. Në momentin që ne do ta miratojmë do ta mbështesi Bashkia Fier këtë projektvendim?

Z.Armando Çupa



Plani, sikurse e përmendi dhe kryetarja, ka një buxhet të miratuar për Këshillin Bashkiak mbi bazën e të cilit operon Këshilli dhe "Bashkitë e Forta" thjeshtë ofrojnë asistencën sepse janë, le të themi, një nga institucionet e akredituara për trajnimin e këshilltarëve .

Znj.Edlira Dyrmishaj

Unë mendoj që ta shtyjme miratimin.

Z.Armando Çupa

Jo sepse jemi me vonesë. Sot jemi në muajin shkurt, po ta shtyjme i bie që ta miratojmë në mars. Ne e miratojmë siç është dhe nqs secili nga ju ka mundësi të llojë për të ardhur një institucion i akredituar për të sjellë grupe për trajnimin e këshilltarëve, apo gjëra të tjera, të cilat vlejné për trajnimin apo ngritjen profesionale të këshilltarëve, ne jemi plotësisht të hapur, por jemi në vonesë për ta miratuar sepse jemi në muajin shkurt.

Znj. Antoneta Çunaj

Po inxhinier!

Z.Ilia Fili

Unë sugjerime kisha. Unë do të thosha që në këtë program do të ishte mirë të ishte përfshirë një shkëmbim eksperiencash midis Këshillave Bashkiak. Në ç'aspekt? Unë njoh mirë Korçën, sepse jetoj një pjesë të madhe të kohës në Korçë. Ne mund të marrim pjesë, një grup i gjerë me përfaqësues nga Këshilli jonë Bashkiak në Këshillin Bashkiak të Korçës, sepse Korça ka disa gjëra shumë me vlerë. E para. Qytet që shtrihet mbi një projekt të miratuar. E dyta: Qytet me gjelbërim rekord. Qytet me asnjë problem me ujin e pijshëm. Qytet me asnjë problem me energjinë elektrike. Qytet me parqe, jo një.

Znj. Antoneta Çunaj

Siç ju thash inxhinier, ne jemi të hapur për shtesa të tjera. Ta miratojmë në parim, dhe çfarë shtesash do të keni, jeni të mirëpritur, sepse dhe këto që thoni ju, duhet të marrë miratimi dhe nga Bashkia që ju sugjeruat, gjith ne jemi të hapur që më vonë të ketë ndryshime. Kjo është në parim, këto kemi sot. Nesër kemi të tjera, hajde ti shtojmë. Tani e miratojmë pikën e rendit të ditës. Kush është pro?

Pro 33 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Janar 2026."

Znj. Antoneta Çunaj

Ky projektvendim është i përmuajshëm. E keni materialin. Sqarime, interpretime, pyetje? S'ka. E hedhim në votim. Kush është pro?



Pro 33 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka .

Miratohet.

Pika e pestë e rendit të ditës.

Projektvendim:"Për shpërndarjen e një banese sociale me qira, e cila rezulton e lirë nga administrimi i banesave sociale me qira pranë bllokut të Banesave Sociale, Lagja 16 Prilli', Fier, për familjet e pastreha."

Znj. Antoneta Çunaj

Tani, komisionet nuk e di a janë mbledhur apo jo, nëse duan fjalën. Kush e do fjalën fillimisht? Fillon komisioni, më pas janë kryetarët e grupeve dhe në fund këshilltarët. E do njeri fjalën? Jeni të qartë?

Znj.Mirela Pitushi

Të flasim ne nënkryetarët?

Znj. Antoneta Çunaj

Jo, jo, jo... po deshën anëtarët e këshillit. Ju thashë pra pjesëtarët e tjerë nga administrata, po patën pyetje anëtarët e këshillit dhe janë të paqartë atëherë futeni ju për sqarime. Nqs anëtarët e Këshillit janë të qartë dhe nuk kanë pyetje, atëherë hidhet në votim.

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë, në cilësinë e n/kryetarit të komisionit, ia kaloj fjalën zonjës Mirela sepse...Mirela është pjesë e komisionit.

Znj. Antoneta Çunaj

Nuk ka delegim të fjalës, vazhdo ti, se e ke ti të drejtën si përfaqësues i komisionit përkatës.

Z.Kreshnik Dapi

Komisioni Ad-Hock i strehimit është mbledhur disa herë brenda kësaj jave. Ka shqyrtuar të gjithë materialin dhe e ka miratuar për ta kaluar në Këshill.

Znj. Antoneta Çunaj

Po. Sqarime ka? E do njëri fjalën nga këshilltarët? Jo. E hedhim në votim pikën pesë të rendit të ditës. Kush është pro?

Pro 33 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka .

Miratohet.

Znj.Mirela Pitushi

Kryetare, më fal se dua të bëj një shtesë... për miratimin.

Znj. Antoneta Çunaj

Jo nuk mund të bësh dot shtesa.

Znj.Mirela Pitushi

Kryetare të lutem! Dua ti bëj një kërkesë Këshillit Bashkiak.

Znj. Antoneta Çunaj

Kërkesë Këshillit Bashkiak? Po dale, në fund pasi të mbarojmë me pikat e rendit të ditës.

Znj.Mirela Pitushi

Duhet ta bëjë tani sepse është në këtë kuadër.

Znj. Antoneta Çunaj

Le të jetë në këtë kuadër. Nuk ndërhyt asnjë përveç këshilltarëve, asnjë njëri tjetër nuk ka të drejtë të ndërhyjë.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të aparatit, të funksioneve dhe të shërbimeve të Bashkisë Fier."

Znj. Antoneta Çunaj

Komisioni përkatës është mbledhur në lidhje me këtë pikë. A dëshironi të flisni? Po.

Znj.Erlinda Llupi

Komisioni përkatës është mbledhur ditën e djeshme dhe vendosi ti kalojë për miratim në Këshill, si pikën gjashtë edhe pikën shtatë të rendit të ditës.

Znj. Antoneta Çunaj

Kryetarët e grupeve duan të flasin? Jo. Anëtarët e Këshillit? Ndonjë anëtar dëshiron të flasë? Po, inxhinier.


Z.Illia Fili

Në mos gaboj kjo është pika për rritjen e pagave duke filluar nga kryetari i bashkisë deri tek punonjësi më i thjeshtë. Besoj kolegët këtu në sallë, e mbanjnë mend diskutimin tim dhe qëndrimin tim për ndryshimin e pagës së kryetarit dhe institucionit të kryetarit të bashkisë në ato vlera që kishte më përpara dhe që ardhur në vlerat që kanë, dhe e argumentova se pse duhet të ishte ky ndryshim. Ndërsa sot, jam absolutisht kundër që të rriten pagat e punonjësve të bashkisë në një kohë kur ka qindra e mijëra pensionistë që zhgryen në ato tavolinat përjashta se s'kanë lekë për një kafe, s'kanë lekë për ushqime, e s'kanë lekë për jetesën më normale, ndërkohë bashkia kërkon rritjen e pagave të tyre. Unë mendoj që ky është një veprim i nxituar, dhe është shumë i nxituar. Mendojeni pak para se të thoni po.

Znj. Antoneta Çunaj

Keni ndonjë pyetje, sqarim për këtë projekt-vendim? Po, Visa ti kërkon sqarim? Po.

9



Znj.Pranvera Cina

Përsëritet! Doja t'ju sqaroja që përcaktimi i nivelit të pagave është bërë në kuadër të ndryshimit ligjor të VKM-ve përkatëse dhe nuk kemi rritje të pagës por kemi indeksim.

Z.Ilia Fili

Për debat. Pse nuk bën indeksime qeveria tek pensionistët, për pensionet? Do të tingëllojë jashtë keq. E kemi gabim.

Znj. Antoneta Çunaj

Është jashtë ! Është jashtë, do t'ju lutesha, jashtë kësaj teme... Është jashtë. Tani inxhinier, të respektoj, por për gjëra që nuk na përkasin ne si Këshill, nuk jemi ne kompetentë. Tani vazhdojmë me hedhjen në votim. Kush është pro për pikën gjashtë të rendit të ditës?

Pro 31 vota.

Kundra 2 vota.

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e shtatë e rendit të ditës.

Projektvendim: : "Për miratimin e ndryshimit (shtesë fondesh nga fondet e trashëguara të vitit 2025) në VKB nr. 118, datë 11.12.2025, Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2026"

Znj. Antoneta Çunaj

Tani, paraprakisht komisionet, nëse janë mbledhur, nëse kanë diskutuar në lidhje me këtë vendimmarrje. Më pas ju thashë, do të marrim fjalën sipas radhës. Po.

Znj.Erlinda Llupi

Patjetër që po, është kaluar për miratim në këshill.

Znj. Antoneta Çunaj

Është miratuar. E do ndonjë nga kryetarët e grupeve fjalën? Jo. Nga këshilltarët ka? Jo. E hedhim në votim. Kush është pro?

Znj.Eleni Gjirkondaj

Një sekondë, do të ndryshoi vendimi, do të bëjmë një ndryshim të vogël për shkak se e kemi arkëtuar... Atëherë, përsëritet të gjithëve. Në kuadër të aplikimit të programit të përfitimit nga fondi për përballimin dhe menaxhimin të fatkeqësive natyrore, kemi përfituar projektin "Rehabilitimi i argjinaturës së lumit Vjosa, segmenti Ferras, Ura e Qarit". Kemi përfituar projektin me vlerën 49 milionë e 254 mijë e 700 lekë, i cili do të financohet në masën 80 përqind nga Ministria e Mbrojtjes dhe 20 përqind nga bashkia. Prandaj do të kemi një ndryshim të vlerat midis programeve... do të pakësohet programi AA 111 në vlerën 9 milionë e 850 mijë e 940 lekë dhe do t'i shtohet programit AB 111 "Siguria Publike dhe Emergjencat Civile" për këtë vlerë dhe do të vejë në vlerat 37 milionë 798 mijë e 630 lekë.

Znj. Antoneta Çunaj

Cili është shkaku që bëhet ky ndryshim?

Znj.Eleni Gjikonaj

Kemi përfituar projektin me bashkëfinancimin nga ana jonë, 20% që duhet ta mbulojmë ne. Kemi ndryshim brenda për brenda.

Znj.Brunilda Hoxha

Të lutem përsëriteni edhe njëherë se nuk dëgjohesh, duhet të kesh mikrofon.

Znj.Eleni Gjikonaj

Ta them edhe njëherë me zë edhe më të lartë?

Znj. Antoneta Çunaj

Atëherë kaloni tek vendi me mikrofon që t'ju dëgjojnë më mirë këshilltarët.

Znj.Eleni Gjikonaj

Atëherë, përshëndetje të gjithëve. Në projektvendim kemi një ndryshim. Tek projekt-vendimi që po diskutojmë kemi një ndryshim tek programi AA 111 dhe tek programi AB111. Do të zvogëlohet programi AA111 për vlerën 9 milion 850 mijë 940 lekë dhe do të shtohet program AB 111 "Siguria publike dhe emergjencat Civile" për këtë vlerë, pasi kemi fituar një projekt në bazë të aplikimit që kemi bërë për përfitim nga fondi "Për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësime natyrore". Kemi përfituar projektin projektin "Rehabilitimi i argjinaturës së lumit Vjosa, segmenti Ferras, Ura e Qarit" në vlerën 49 milion 254 mijë e 700 lekë është vlera e plotë e projektit por ne do të financojmë bashkëfinancimin në vlerën 20% që kjo vlera 9 milion 850 mijë 940 lekë. Pjesa tjetër do të mbulohet nga Ministria e Mbrojtjes nga AKMC-ja. Faleminderit!

Znj. Antoneta Çunaj

Ka ndonjëri që do sqarim? Jo. E hedhim në votim. Kush është pro me pikën shtatë të rendit të ditës?

Pro 31 vota.

Kundra 2 vota.

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e tetë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për dhënien e ndihmës shtetërore financiare për familjet e fshatrave të Njësisë Administrative Levan nga përmbytjet e shkaktuara nga lumi Vjosa në datën 08.01.2026, si dhe për familjet e Njësisë Administrative Nr. 2 Mbrostar Ura dhe Libofshë nga përmbytjet e shkaktuara nga lumi Seman në datën 11.01.2026.

Znj. Antoneta Çunaj

Komisioni përgjegjës është mbledhur në lidhje me këtë projekt-vendim?

11

Z.Kreshnik Dapi

Përsëritje! Po, komisioni është mbledhur. I ka shqyrtuar të gjitha materialet në mbledhje. Çdo gjë është korrekte dhe konformë ligjit. E kemi kaluar në komision, dhe ju lutemi ta kalojmë për miratim dhe në këshill.

Znj. Antoneta Çunaj

Po, faleminderit. Nga kryetarët e grupeve ka fjalën ndonjëri? Jo. Anëtarët? Jo. E hedhim në votim. Kush është pro?

Z.Ilia Fili

Prisni, prisni... Kemi pyetje. Pyetje, pyetje. Ka familje që pretendojnë që janë prekur dhe nuk janë përfshirë këtu? E para kjo. E dyta: A janë verifikuar me përgjegjësi dhe të tëra këto familje që janë në listë, janë të dëmtuara apo jo? Dua përgjigje. Dhe të dyja përgjigjet i dua të protokolluara.

Znj. Antoneta Çunaj

Tani të flasë, përpara se t'ia japim fjalën përfaqësuesve të bashkisë, a do njeri... apo e do fjalën Niku? Po.

Z.Kreshnik Dapi

Zonja kryetare. Në respekt të kolegut , pyetja e parë që ne ngritëm brenda komisionit ishte nëse kishim ankesa, kontestime apo probleme të këtij lloji me banorët e zonave të përmbytura. Na u tha në mënyrë të qartë dhe konkrete që nuk ka pasur asnjë lloj ankese dhe kontestimi. Për pjesën dërmuese, të gjithë banorët janë të kënaqur me punën e grupeve të konstatimit në terren dhe i kanë pranuar të gjitha procesverbalet.

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit Niku! Tani përfaqësuesi i bashkisë nëse ka përgjigje për pyetjen që bëri këshilltari? Po.

Z.Nustret Avdullai

Besoj se Niku e shprehu përgjigjen, por po e them edhe njëherë. Nuk ka pasur asnjë ankesë apo kontestim. 112 familje, 104 në komunën Levan dhe Frakull, pra nga lumi Vjosa , dhe 8 familje të përmbytura nga lumi Seman, janë të përfshira të gjitha, familjet e prekura nga përmbytja. Është bërë një vlerësim shumë i shpejtë, janë ngritur grupet e punës, janë përcaktuar, kaluan në Qark vlerësimin e dëmeve dhe së shpejti do të marrin dëmshpërblimin e duhur.Faleminderit!

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit. Pyetje tjetër ka? Nuk ka. E hedhim në votim. Kush është pro pikës tetë të rendit të ditës?

Pro 33 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka .

Miratohet.

Pika e nëntë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për dhënien e titullit Qytetar Nderi' z. Miti Nushi dhez. Llazar Pove "

Znj. Antoneta Çunaj

Fillimisht, nëse komisioni është mbledhur dhe pasandaj kanë të drejtë të flasin. Po.

Znj. Brunilda Hoxha

Komisioni u mbledh, dhe u mbledh dy herë, pasi pjesëmarrja në mbledhjen e parë nuk ishte e mjaftueshme. U mbledhën përsëri ata që munguan në mbledhjen e parë, erdhën në mbledhjen e dytë, kështu që komisioni ishte i tëri në një zë që kjo çështje le të diskutohet në mbledhjen e ardhshme, sepse në brenda këtij komisioni diskutuam ato gjëra që i menduam se duheshin trajtuar, dhe lindi ky propozim që kjo pikë le të diskutohet në një mbledhje tjetër të ardhshme.

Znj. Antoneta Çunaj

U mor nga ana juaj ndonjë vendimarrje?

Znj. Evis Sema

Ishin të gjithë anëtarët e komisionit ?

Znj. Brunilda Hoxha

Ishin të gjithë anëtarët prezent.

Znj. Antoneta Çunaj

Një minutë Visa.

Znj. Evis Sema

Pse nuk jam e lejuar që të flajë unë?

Znj. Brunilda Hoxha

Të lutem Visa mbaj vendin.

Znj. Antoneta Çunaj

Je anëtare e komisionit ti Visa?

Znj. Brunilda Hoxha

Jo nuk është anëtare e komisionit Visa.

Znj. Antoneta Çunaj

Të lutem atëherë Visa mos fol pa të dhënë fjalën. Në komision ka patur tjetër përveç Brunës? Në grup kush është? Je në Komision?

Z. Rrapi Gjika

Jo nuk jam në komision por dua të flas.

Znj. Antoneta Çunaj

13

Në komision ka patur tjetër? Kush është në Komision tjetër përveç Brunës? Po vazhdo. Bruna të dëgjova që fole.

Znj. Brunilda Hoxha

Desha t'ju tregoj se cili është në Komision.

Znj. Antoneta Çunaj

Po zotëria që po kërkon fjalën është në Komision?

Znj. Brunilda Hoxha

Po është edhe zotëria.

Znj. Antoneta Çunaj

Po zotëri vazhdoni

Znj. Brunilda Hoxha

Të lutem... të lutem, nuk kam mbaruar... Unë mbaroj kur mbaroj unë. Problemi është këtu që ne shikojmë gjithë këto diskutime këtu dhe pasi kryetari i komisionit jep vendimin, asnjëherë ju nuk pyesni anëtarët e tjerë.

Znj. Antoneta Çunaj

Po nqs ka kundërshtim, po i pyes. Nqs anëtarët e komisionit nuk janë dakort... kërkuan fjalën, ngritën dorën

Znj. Brunilda Hoxha

Pse dyshoni?

Znj. Antoneta Çunaj

Po kërkuan fjalën, ngritën duart. Ka qënë në komision ai që ngriti dorën, po apo jo?

Znj. Brunilda Hoxha

Ai që ngriti dorën nuk është anëtar komisioni.

Z. Arnando Çupa

Kryetare, më fal! Bruna të lutem për sqarim. Jo më larg sesa një apo dy mbledhje ne kemi lejuar që Z. Dapi i cili në një vendimarrje ishte në minorancë të lexonte vendimarrjen e tij. Apo nuk është kështu?

Znj. Antoneta Çunaj

Po. Ka lexuar dy raporte.

Z. Arnando Çupa

Më fal kryetare ta mbarojë. Nqs ka dy raporte, le të relatohen dy vendimarrjet. Nqs komisioni është në një mendje flet kryetari i komisionit i cili shpreh vendimin për gjithë komisionin. Nqs ka dy raporte, atëherë ka një raport të shumicës ka dhe një raport të minorancës.

14

Znj.Brunilda Hoxha

S`kemi ndarje ne, jemi vetëm shumicë. Ishim të gjithë dakort.

Z.Armando Çupa

Ky ishte një sqarim përsa i përket procedurës. Faleminderit!

Znj. Antoneta Çunaj

Fillimisht do pyeten anëtarët e komisionit pastaj keni të drejtë të tërë anëtarët e këshillit, duroni.Po se do të flasi anëtari i Komisioni, çfarë të bëj unë?

Z.Agron Profka

Mqs radhën e parë nuk isha prezent dhe ishin mbledhur katër veta, po sot janë mbledhur përsëri katër veta. Pas diskutimeve të shumta, mes katër anëtarëve u vendos, dy anëtarë propozuan që të shtohet edhe emri i Jani Tases, veç këtyre të dyve si themeluesi i grupit. Mqs kryetarja ngul këmbë që të marri komplet grupi si përfaqësi dhe jo si individ. Tani unë nuk jam dakort me grupin, duke patur një eksperiencë sportive që mund të ketë lozur një ndeshje dhe të marri titullin “Qytetar Nderi” Prandaj nuk jam dakort që ti jepet titulli grupit, por ta marrin ata që janë propozuar.

Znj.Brunilda Hoxha

A re dakort ti që ta shtyjme për radhën tjetër?

Znj. Antoneta Çunaj

Kush ka qënë tjetër në komision?A u mor vendimarrje? Sa vendimarrje u morën?

Znj.Evis Sema

Nuk është grupi që po e merr janë dy individë.

Znj.Brunilda Hoxha

Mos e ndërro mendimin që dhe në komision, sepse më nxjerr mua gënjeshtare përpara Këshillit. Ne ramë dakort që ne këtë çështje ta diskutojmë për njëherë tjetër.

Znj. Antoneta Çunaj

Ju si komision? Dakort. Kush e do fjalën tjetër ?

Z.Rrapi Gjika

Është shtyrë dy herë kjo puna e këtyre artistave, dhe është turp i madh që ne, asnjë nuk ka fytyrë që të kundërshtojë për ti dhënë titullin “Qytetarë Nderi” dy artistave që na kanë përfaqësuar .


Znj.Evis Sema

Madje ata sot duhet të ishin këtu të dëgjonin dhe të iknin vërtet si qytetarë nderi.

Z.Rrapi Gjika

As artistave dhe as sportistave ne nuk duhet ti kundërshtojmë asnjëherë. Është turp i madh.

15



Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit , Rrapi! Kush e do fjalën tjetër? Po Gëzim.

Z.Gëzim Hajdëraj

Tani unë i dëgjova pak parafolësit por mu duk një çik si diferencim kjo ideja që vetëm artista dhe sportista. Po edhe inxhinierët e naftës për shembull e meritojnë.

Znj. Antoneta Çunaj

Po këto janë kërkesat sot, kur të vijmë kërkesat e tjera , bujrum. E do njëri tjetër fjalën nga këshilltarët? Po.

Znj.Sonila Meço

Siç e tha edhe Bruna, komisioni është mbledhur dy herë, dhe në të dyja herët kanë qënë present katër anëtarë komisioni edhe pa qënë kushtet për të bërë votimin, me kundërshtimin e kryetares së komisionit që nuk ishte dakort për ta kaluar këtë si propozim. Votimi ishte në kushtet që mos të bëhej me katër anëtarë dhe është propozuar nga kryetarja e komisionit që të shtyhet kjo vendimarrje.

Zn.Evis Sema

Po pse neve këshilltarëve të tjerë nuk na merret mendimi, vetëm komisionit?

Znj. Antoneta Çunaj

Visa të lutem të flasim me radhë. Po vazhdoni.

Znj.Elida Sopot

Atëherë, përshëndetje të gjithëve. Propozimi për të dy këta artistë ka ardhur nga shoqata "Bashkimi i Fierakëve në Greqi" (ose Omonia), që është shoqata më e madhe që ekziston në këto momente në komunitetin shqiptar në Greqi. Dhe për këtë jemi shumë krenarë, falë të gjithë fierakëve që na kanë mbështetur dhe na mbështesin. Në mbledhjen që u bë nga asambleja e shoqatës sonë, u propozua që këta dy artistë, zoti Mit Nushi dhe Llazar Pove të marrin titullin 'Qytetar Nderi' të qytetit tonë. Për shumë arsye që ju të gjithë i dini, por unë do t'i veçoj një nga një, duke thënë se si Llazari, si zoti Miti, që të dy janë ata që na përfaqësojnë neve edhe sot e kësaj dite me këngën qytetare fierake. Atëherë, kush më shumë se këta e meriton këtë titull? Që nga '63-shi edhe deri më sot, 82 vjeçar, sot ai i ngjitet skenës dhe na përfaqëson denjësisht. Gjithashtu edhe Llazari. Llazar Pove, përveçse ka qenë pjesë e grupit, vazhdon traditën me një grup të ri, të ngritur po prej tij dhe vazhdon tradita e këngës tonë që mos të shuhet. Kush më shumë se këta? Unë mendoj që ky propozim nga ana jonë është i vonuar. Duhet të bëhej më përpara nga ju, jo të vinte nga emigracioni. Por jam shumë krenarë që shoqata jonë bëri këtë propozim dhe nuk jam fare dakord që të shtyhet, nuk ka arsye. Dhe për informacion, dua t'ju theksoj që shoqata jonë është e ligjëruar nga Gjykata e Lartë e Shtetit Grek me numër NIPTI (ose AFIMI në Greqi) me numër 99 64 03 059, mund të kontrollohet dhe të vërtetohet kjo. Nuk jam dakord që të shtyhet! Për mos informacion, kisha përshtypjen sikur zoti Jani Tase, i ndritë shpirti atje ku është, e kishte marrë këtë titull. Do ishte në nderin tonë që edhe zoti Jani Tase nëse mundet edhe sot të votohet dhe ta marrë këtë titull. Ju faleminderit dhe shpresoj që të votohet sot.

Znj.Brunilda Hoxha

16

Zonja kryetare, unë bëra thjesht një prezantim të komisionit. Në qoftë se ne do të trajtojmë dhe të zhvillojmë sot propozimin që ka ardhur, duke menduar unë që do të bëhej në një ditë tjetër, unë si artistja, profesioniste e qytetit tim, jam dëshmitare e shumë fakteve, e gjithë muzikës që ka kaluar në këtë qytet, edhe jam në gjendje t'ju paraqes dokumentat konkrete, jo siç tha zonja '63-shi. Nëse nuk ka...

Znj.Evis Sema

Pse histori do të bëjmë ne këtu

Znj.Brunilda Hoxha

Visa të lutem mos më ndërhy. Zonja këshilltare, të lutem shumë! Kryetare të lutem mbyllja gojën kësaj Visës.

Znj.Elida Sopoti

Po si u mbyllka goja, në çfarë mënyre?

Znj.Brunilda Hoxha

Nuk po flas me ty. Të ndërhyra unë ty?

Znj. Antoneta Çunaj

Lida të lutem një minutë. Bruna duro. Më kthe mua përgjigje. Ja mbyll unë këtyre gojën.Ti Lida mbylle gojën?

Znj.Elida Sopoti

Unë?

Znj. Antoneta Çunaj

Të kam shumë xhan por mbylle gojën. Ta dëgjojë njëherë se çfarë ka ajo.

Znj.Elida Sopoti

Ok, po jo mbylle gojën

Znj. Antoneta Çunaj

Jo jo më fal, nuk ta them për ashtu. Dale se nuk merr vendim as ti dhe as ajo, e marrin të tërë këshilltarët. Nuk e merr Bruna vendimin, e marrim të tërë bashkë. Të më falësh ëë, të më falësh se nuk e kam thënë asnjëherë, por dale, se po e bëni kështu sikur ça u bë për dy qytetarë fierak që janë të nderuar sot. Të flasi Bruna njëherë dhe do t'ua jap me rradhë fjalën. Dale mos bëni zhurëm. Po Bruna se ta dhashë njëherë fjalën. Se ka një gjë , secili ka të drejtë ta marri vetëm një herë fjalën për një çështje sepse kështu e ka rregullorja, nuk mund të flasësh shtatë herë për një çështje.

Znj.Evis Sema

Kryetare po ka debat Këshilli.

Znj. Antoneta Çunaj

Për një çështje po them. Vazhdo Bruna.

17

Znj.Brunilda Hoxha

Unë do ti lutesha kujtdo qoftë ...të lutem Visa se po flas, kjo është mungesë respekti. Unë dua ta përcjell për gjithë Këshillin. Të lutem, të lutem, unë dua ta përcjell për gjithë Këshillin gjithë njohurinë e muzikës së qytetit tonë. Sepse pjesa dërrmuese këtu janë moshë e re. Pjesa tjetër është brez i mesëm, dhe pjesa tjetër është brezi im, i Agronit e të gjithë të tjerëve që janë dëshmitarë. Atëherë, për të parën herë, grupi i parë i këngës qytetare fierake është krijuar në vitin 1975 dhe quhej 'Grupi Vokal Instrumental i Këngës Qytetare Fierake'. Në vitin 1986, Jani Tase ka krijuar 'Grupin e Këngës Qytetare Fierake'. Jani Tase është një nga muzikantët e vlerësuar nga Vasil Tole, Doktor i Shkencave të Muzikës... Kemi edhe këtu Jani Tase...

Znj. Antoneta Çunaj

Iku Jani Tase, herën tjetër këtu jemi si këshill...

Znj.Brunilda Hoxha

Atë po them dhe unë ta bëjmë herën tjetër

Znj. Antoneta Çunaj

Atë nuk e di ti, e voton Këshilli, nuk e bën njëri, jo një anëtarë.

Znj.Brunilda Hoxha

Këshilli duhet sqaruar pse janë dy tre veta nuk na sjellin ...

Znj. Antoneta Çunaj

Do të votohet , nuk e detyron ti Këshillin se si do të votohet.

Znj.Brunilda Hoxha

S'po e detyron njëri Këshillin. Unë jam e gatshme ti tregoj Këshillit historikun.

Znj. Antoneta Çunaj

Dakort, por po deshën ata, po nuk deshën ...Po Gëzim.

Znj.Brunilda Hoxha

Po nuk kam mbaruar unë moj kryetare.

Znj. Antoneta Çunaj

Po mbarove ti. Ç'farë e the e the.


Znj.Brunilda Hoxha

Më mbarove ti, jo se mbarova unë, të lutem tani, nuk mund të bëhen këto gjëra kështu.

Znj. Antoneta Çunaj

Ata nuk duan sqarim, çfarë të bëj unë?

Znj.Brunilda Hoxha



Kush janë ata?

Znj. Antoneta Çunaj

Anëtarët e këshillit. Anëtarëve të Këshillit Bashkiak u ka vajtur materiali dhe janë të qartë për vendimmarrjen.

Znj. Brunilda Hoxha

Në asnjë mënyrë.

Znj. Yllka Sheshi

Është bërë mbledhja e komisionit dhe e kemi lënë për në mbledhjen pasardhëse.

Znj. Antoneta Çunaj

Po e morëm vendimmarrjen e komisionit, dakort e dëgjuam që ju e latë për në mbledhjen pasardhëse. Do të vendosi Këshilli, nuk vendosni ju si Komision.

Znj. Brunilda Hoxha

Atëherë kot që na mblidhni. Komisioni për çfarë është?

Znj. Antoneta Çunaj

Komisioni pesë anëtarë ka, këshilli është pesëdhjetë e një.

Znj. Brunilda Hoxha

Kryetare, sa herë që është thënë që kjo çështje do të diskutohet në mbledhjen e ardhshme, kanë rënë dakort të gjithë. Unë kam për borxh si artiste e qytetit, të bëjë prezantimin përpara këshilltarëve.

Znj. Evis Sema

Ka dy prezantime, prezantim të kryetares së komisionit dhe prezantim të anëtarëve të tjerë. Pse nuk merreni me prezantimin tjetër. E para kjo. E dyta. Ne vërtetë kemi rënë dakort për shtytje, por kur kemi qënë të tërë unanimit në një mendje.

Znj. Brunilda Hoxha

Komisioni është unanimit.

Znj. Evis Sema

Çfarë unanimit është komisioni, nuk është unanimit. Kryetare hidhe në votë.

Znj. Antoneta Çunaj

Dakort! Komisioni ka qënë për ta shtyrë do ta vendosi këshilli. Po Gëzim.

Z. Gëzim Hajdëri

Për procedurë. Tani nqs ka ardhur projekt-vendimi në Këshill, dhe është për shqyrtim, ka kaluar në rendin e ditës, ka kaluar kjo pikëpamje procedurale që diskutohet do të shtyhet apo nuk do të shtyhet. Pra ka hyrë. Tani vendimmarrja i përket këshillit dhe jo komisionit.

Znj. Antoneta Çunaj

Këtë po them.

Z.Armando Çupa

Më fal kryetare, ta sqaroj dhe njëherë në mënyrë përfundimtare që mos të ketë ambiguitet përse i përket procedurës, sepse ngrihet pretendimi se përse mblidhet komisioni. Në bazë të rregullores, komisioni mblidhet për të trajtuar problematikat. Në rastin konkret, mesa kuptojmë ka dy raporte, pra është ndarë dy me dy. Pavarësisht se kanë patur kuorumin për të marrë vendim nga shtatë anëtarë , kanë qënë katër anëtarë, nuk ka arritur të ketë një raport të vetëm.

Znj.Brunilda Hoxha

E ke gabim, u mor, u mor që me të parën herë por që të ishte më i përforcuar i thirra përsëri. E ke gabim.

Znj. Antoneta Çunaj

Ju lutem ndaloni së foluri. E ka fjalën inxhinieri.

Z.Illia Fili

Unë ju kërkoj personalisht të diskutoni me qetësi. Vetë nuk jam i lindur këtu në Fier por kam 50 vjet që jetoj dhe banoj në Fier, dhe natyrisht që e quaj veten Fierak dhe fëmijët e mi natyrisht që janë edhe ata Fierak. Vlora ka ansambël, këngëtarë të këngës polifonike dhe të këngës qytetare Vlonjate. Të njëjtën gjë ka Korça. Të njëjtën gjë ka Dibra, Shkodra, Elbasani të njëjtën gjë duhet të ketë dhe Fieri. Dhe unë këta artista që përpiqen të mbajnë gjallë këtë këngë qytetare Fierake, që është e bukur. Dhe kur them është e bukur mua më tërheq, e pëlqej. Pse duhet të debatojmë kaq me zjarrë? Le ta bëjmë këtë debat me kaq zjarrë për pikën që vjen mbrapa kësaj, që është informacioni. Shyqyr që zjeu njëherë ky këshill.

Znj.Brunilda Hoxha

Do të përshëndes me një këngë myzeqare shumë të bukur, inxhinier

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit inxhinier. Po Marjus Voja.

Z.Marjus Voja

Propozoj që këtë pikë ta shtyjmë për në mbledhjen e radhës për të marrë një vendimmarrje sa më të duhur.

Znj. Antoneta Çunaj

Do ta votojmë ne njëherë.

Znj.Brunilda Hoxha

Dëgjoni kryetarin e grupit.

Znj. Antoneta Çunaj

Vazhdoni këshilltare.

20

Znj.Floreta Gjino

Përsëritje! Jam Floreta Gjino, dhe jam pjesë e komisionit, dhe ju lutem më dëgjoni dhe pse nuk flas me zë të lartë. Unë personalisht do të kërkoja një pyetje se komisioni u mbledh dhe e shtymë në mbledhjen e ardhshme jo për të vendosur qytetarë nderi vetëm dy persona por për ta parë në një këndvështrim më të gjerë, për të parë të gjithë grupin, dhe për të vlerësuar të gjithë grupin. Është një punë e cila në fakt duhet të vlerësohet, por këtu në gjithë këtë zhurmë që u bë tani, çfarë vë re unë, dhe çfarë po shikoj. Puna është që në momentin që ne do të vendosim tek një person titullin “Qytetarë Nderi” atëherë duhet të dimë se cilat duhet të jenë këto kritere që duhet të kenë këta persona dhe njëkohësisht të jenë kritere të matëshme për të qënë sa më tepër objektiv, sepse nqs flasim vetëm nga këndvështrimi i një grupi të caktuar, kjo merr subjektivizëm, dhe kështu që ne jemi kaq shumë mendje dhe nuk biem dot në dakortësi. Prandaj mendoj që është më mirë le të merren të gjitha të dhënat e ta bëjmë të marri vlerësim i gjithë grupi sepse është më mirë kështu.

Znj.Elida Sopoti

Cili grup?

Znj.Brunilda Hoxha

Grupi i Jani Tases.

Znj.Elida Sopoti

Është një grup që nuk ekziston më.

Znj.Brunilda Hoxha

S'mund ta hedhësh poshtë rolin e Jani Tases ti, se ka vdekur Jani. Është turp i madh që flet në atë gjuhë. Vdiq Jani dhe ti do ta hedhësh poshtë grupin. Mos e hidh Jani Tases poshtë, mos e hidh.

Znj.Evis Sema

Kryetare, kush i përcakton këto kritere?

Znj.Elida Sopoti

Kush e hodhi? Nuk e hodha poshtë. Thashë që nuk kisha informacion për Jani Tases që nuk e kishte marrë, mendoja se e kishte marrë. M gjith propozimi ka ardhur dhe është me emra. Tre ishin grupi, kush ishte grupi?

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk varet nga unë.

Znj.Brunilda Hoxha

Të lutem mos ma mbyll mikrofonin.

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk varet nga unë.

Znj.Brunilda Hoxha

Do ta lëmë për herën tjetër.

21

Znj.Antoneta Çunaj

Jo, jo, jo ... është në dorë të këshillëtarëve dhe jo nga unë.

Znj.Brunilda Hoxha

E hedhim, dakort jam.

Znj.Antoneta Çunaj

Vazhdo Niku.

Z.Kreshnik Dapi

Për sa i përket debatit në fjalë, mqs e shikoj që brenda Këshillit ka shumë konfuzion, dhe realisht për të qënë korrekt edhe me dy zotërinjtë, Z.Pove dhe Z.Nushi, ne nuk kemi asgjë me figurën e tyre morale dhe qytetare. Ata janë njerëz të nderuar madje kanë hyrë në pjesën më të madhe të familjeve, duke filluar nga unë i pari, në familjet tona, në gëzimet tona. Ideja është që ne këtu jemi ligjvënës vendor, dhe aty përveç këtyre dy zotërinjëve, ka patur në historikun e të gjithë këtij grupi, dhe të gjithë artit Fierak, ka patur edhe shumë persona të cilët nuk jetojnë më, nuk kanë sot pasardhës ose njerëz që të "lobojnë " për të marrë atë që ata vërtet kanë merituar. Dhe do të ishte më e llogjikshme nga ana jonë si këshilltarë dhe si Këshill Bashkiak, që duke marrë shkas për mirë nga dy zotërinjtë në fjalë, ne të thellohemi, ta shtyjmë për mbledhjen tjetër dhe të fillojmë pikë së pari me grupin e këngës myzeqare Fierake, pastaj le të kalojmë tek emrat e përveçëm. Nuk e kuptoj pse kjo ngutje. Ne si grup duam ta shtyjmë për mbledhjen tjetër.

Z.Rrapi Gjika

Kjo është qesharake. Ndoshta këto janë marrëdhëniet personale që shumica i ngatërrojnë edhe me punën e këshillit edhe me kontributin e këtyre qytetarëve. Unë si qytetar Fierak nqs sot nuk do të kalojë, dhe ata nuk do të votohen, ky është turp, është turp i madh.

Znj.Brunilda Hoxha

Po çfarë turpi është? Çfarë turpi po bëjmë? Po kërkojmë ta marri në mënyrë të përbashkët grupi i Jani Tases. Kaq.

Znj.Antoneta Çunaj

Ju lutem Visa, Bruna, më falni, të flas dhe unë një minutë? Ka një gjë. "Qytetarë Nderi" pse do të bëjmë këta dy të nderuar këngëtarë të këngës qytetare Fierake, mendimi im personal, është që përderisa këta e ushtrojnë këtë aktivitet edhe jashtë trojeve Shqipëtare, është një vlerë e shtuar. E dyta. Nëse ka kërkesa të tjera në lidhje me këtë grup, kur të duan për pjestarët e tjerë të grupit le ti sjellin. E hedhim në votim. Kush është pro këtij projekt-vendimi ?

Znj.Evis Sema

Kretari i grupit, ngrije kartonin.

Z.Rrapi Gjika

A qënkeni kundër ju nga Mallakastra, bravo ju qoftë! Ju se njihni qytetin fare. Po ty Bruna të të vijë turp, e kthen personale ti.

Znj.Brunilda Hoxha

Mua të më vijë turp? Unë jam Fierake.

Znj.Evis Sema

Anisa ishte pro.

Znj.Anisa Mone

Tani duhet të durojmë edhe konfliktet personale, nuk e di se çfarë është kjo, është nivel shumë i ulët.

Znj.Antoneta Çunaj

Jo jo nuk është konflikt personal. Votoni njëherë këtu pastaj ikni. Një minutë. Kush janë votat pro? Votat pro. Ngrini duart kush janë kundra se protë nuk i numëroj dot kështu si po bëni ju. 2 vota kundra. Sa abstenime janë? 10 vota abstenime.

Z.Melsi Bogdani

Pro sa ishin?

Znj.Antoneta Çunaj

Sa vota janë pro sekretar?

Z.Armando Çupa

10 vota abstenim dhe 2 vota janë kundra.

Z.Evis Sema

Pjesa tjetër sa janë?

Z.Armando Çupa

Ju lutem ngrini edhe njëherë votat pro ti numëroi kryetarja.

Znj.Antoneta Çunaj

Sa është numri gjiththsej

Z.Evis Sema

Kryetare, i ftoj këshilltarët të qëndrojnë tek ato propozimet që kanë ardhur. Nëse duan për të gjithë grupin le ta sjellin mbledhjen tjetër dhe e votojmë.

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk duan ta votojnë këtë radhë, nuk duan ti bëjnë këtë radhë. Nuk miratohet, çfarë të bëjmë? Radhën tjetër e diskutojmë prapë.

Z.Rrapi Gjika

O kryetare, po ne kemi pranuar spiuna këtu, që si njohim fare dhe i kemi bërë qytetarë nderi, jo nga Amerika jo nga....nuk është turp kjo? Të lobohet brenda Këshillit për të mos votuar dy qytetarët e Fierit?

23

Znj.Antoneta Çunaj

Radhën tjetër.

Znj.Brunilda Hoxha

E mira është që kjo të shtyhet, të jenë gjërat e pastruara, sepse është një rrëmujë e madhe që nuk merret vesh se kush po voton e si po votojnë, kështu.

Znj.Antoneta Çunaj

Çfarë nuk merr vesh? E ke gabim, Bruna, sepse votimi është transparent dhe nuk është ashtu siç thua ti. Absolutisht, të gjitha votat pro apo kundra apo abstenim janë numëruar.

Znj.Brunilda Hoxha

Kjo pikë nuk duhet të kalojë fare.

Z.Armando Çupa

Kryetare, si përfundim me 10 abstenime, 2 vota kundër dhe 8 vota pro nuk kalon, nuk miratohet.

Znj.Antoneta Çunaj

Pra nuk kalon dhe do të shtyhet në mbledhjen pasardhëse.

Z.Evis Sema

Të lutem kryetare, me 8 vota pro, 2 vota kundra dhe 10 vota abstenim nuk bëhet kuorumi.

Z.Ilia Fili

Po e shkel rregulloren hapur, je në shkelje, nuk ke kuorum.

Znj.Antoneta Çunaj

Ju lutem uluni. Kryetarët e grupeve të ruajnë pjesëmarrjen në mbledhje sepse ndryshe po u larguan pa arsye ka masa ndëshkuese. Nuk u miratua.

Z.Ilia Fili

Je në shkelje kryetare.

Z.Evis Sema

Kanë votuar 20 këshilltarë, nuk bëhet kuorumi.


Znj.Brunilda Hoxha

Aq ishin, nuk donin të votonin.

Znj.Antoneta Çunaj

Nuk ka kaluar për shkak të kuorumit, radhën tjetër e hedhim përsëri. Ka mundësi të kalojmë në pikat e tjera?

Z.Melsi Bogdani



Kryetare, kryetare mund të flas?

Z.Ilia fli

Kryetare nuk vazhdon dot mbledhjen se nuk ke kuorum.

Z.Melsi Bogdani

Nuk vazhdon mbledhjen pa e marrë unë fjalën.

Znj.Antoneta Çunaj

Aq ishin, nuk donin të votonin. Është kuorumi, dale ti numëroj se sa janë. Dale një minutë, sa të shikoj kuorumin, ka mundësi një minutë.

Z.Melsi Bogdani

Kryetare për respekt mund të marrë fjalën?

Znj.Antoneta Çunaj

Jo, jo, jo, nuk ta jap fjalën se po verifikoj kuorumin.

Z.Melsi Bogdani

Mirupafshim atëherë!

Znj.Antoneta Çunaj

Ikni, ikni e keni punën me kryetarin e grupit.

Z.Evis Sema

Kryetare, duhet të japësh fjalën se po ikin këshilltarët.

Z.Melsi Bogdani

Kryetare, ti drejton seancën por gojën nuk ma mbyll dot.

Znj.Antoneta Çunaj

Kur të ta jap unë fjalën , jo kur do ti.

Z.Arnando Çupa

Kryetare, ka rënë kuorumi. Aktualisht është numri 24 këshilltarë.

Znj.Antoneta Çunaj

Le të ikin unë nuk kam se çfarë të bëjë. Shiko dhe njëherë kuorumi një më një. Agron të lutem mos u largo se bie më tepër kuorumi, ka mundësi të rrish? Ka mundësi që të miratojmë dhe pikat shtesë? Nuk doni të rrini, ikni. Atëherë 5 minuta pushim sa të bëhet kuorumi. Ja erdhën këshilltarët, hajdeni, hajdeni.

Z.Melsi Bogdani

25

Erdha për bonusin e qerasë se digjet fondi, nuk erdha se thua ti kthehu, jo ta kesh të qartë. Gojën nuk ma mbyll dot. Kur ngre dorën duhet të ma japësh fjalën. Kam një orë në mbledhje dhe s'po marrë dot fjalën.

Znj. Antoneta Çunaj

Jo, jo nuk po të mbyll gojën, kur të jap unë fjalën do të flasësh. Tani të vazhdojmë mqs u krijua kuorumi.

Pika e dhjetë e rendit të ditës.

Infomacion Këshillit: Mbi Raportin e Monitorimit 12-mujor të Buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2025"

Znj. Antoneta Çunaj

Pika e dhjetë është thjeshtë informacion për këshillin, I cili ju ka ardhur elektronikisht, dhe nuk ka nevojë për votim.

Pika e parë shtesë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për miratimin e formalizimit të marrëdhënies juridike për dhënien në përdorim pa kundërshpërblim, njësisë vendore të kujdesit shëndetësor Fier, të objektit Qendra Shëndetësore numër 3, me numër pasurie 12/397, zona kadastrale 8552, me sipërfaqe 820 metër katror, e ndodhur në lagjen 'Iliria', Fier, pronë e Bashkisë Fier."

Znj. Antoneta Çunaj

Ky material ju ka ardhur tani rishtazi, ju e keni marrë të gjithë materialin. Keni pyetje dhe diskutime?

Jo. E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 33 vota

Kundra s'ka .

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.

Projektvendim: "Për një ndryshim në VKB numër 12, datë 29.01.2026, për miratimin e subvencionit të qerasë për familjet e pastreha që banojnë me qera në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vlerën e qerasë."

Znj. Antoneta Çunaj

Keni nevojë për sqarime apo interpretime? Kush e do fjalën? Po Niku, vazhdo.

Z.Kreshnik Dapi

Komisioni është mbledhur, çdo gjë është konform ligjit, propozoj ta kalojmë.

Znj. Antoneta Çunaj

E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 33 vota.

Kundra s'ka .

26

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Znj. Antoneta Çunaj

Tani nënkryetarja e bashkisë çfarë kishte për të sqaruar mqs kërkoi fjalën gjatë mbledhjes? E doni fjalën?

Z.Armando Çupa

U sqarua. E kishte shqetësimin për bonusin e qerasë.

Znj. Antoneta Çunaj

E doni fjalën?

Znj.Mirela Pitushi

Më fal zonja kryetare, doja një sqarim, sepse e pashë se si funksionon pjesa e Këshillit Bashkiak. Unë vij nga një detyrë e mëparshme ku pak a shumë veprohej në të njëjtën mënyrë, si deputete e Kuvendit të Shqipërisë, dhe normalisht shprehet nismëtari përsa i përket projektligjeve, projektvendimeve. Me sa vura re, të gjithë projekt-vendimet kaluan pa u shprehur nismëtari. Ligji është njësoj si për pushtetin qendror dhe për pushtetin vendor

Znj. Antoneta Çunaj

Jo nuk është kështu këtu. Shiko rregulloren, dhe nqs këshilltarët nuk ju kërkojnë sqarime dhe janë të sqaruar, nuk mund të flisni. Po qenë ata të paqartë atëherë ju keni të drejtë për të ndërhyrë.

Me kaq mbledhjen e deklarojë të mbyllur duke ju falenderuar për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin!

Ky procesverbal ka 27 (njëzet e shtatë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit

Z. Armando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Armando Çupa



Kryetar i Këshillit

Antoneta Çunaj

